

FJALA E DEPUTETIT FATMIR MEDIU

E ENJTE 21 PRILL 2022

Zoti Rama,

E para, ridiculizimi i proceseve për zgjedhjen e Presidentit të Republikës nuk është i denjë për asnjë deputet në këtë Kuvend, për më tepër për Kryeministrin. Historitë e zgjedhjes së Presidentit apo tavolinat, që janë kryesuar nga opozita dhe pozita për zgjedhjen e autoritetit më të lartë të shtetit, kanë pasur në thelb dëshirën për të komunikuar dhe për të gjetur konsensus. E kemi realizuar këtë konsensus në vitin 2002 me vullnetin e përbashkët të palëve për të gjetur një president që të qëndronte mbi palët. Kemi tentuar edhe në vitin 2007, edhe në vitin 2012 dhe kandidati ushtarak, që thoni ju, nuk ka ardhur nga ne, ka ardhur nga ju.

Unë në pozicionin e ministrit pa dyshim që kisha njohje, por vullneti dhe kërkesa ka qenë nga ana juaj si opozita e asaj kohe. Për më tepër, dua t'ju them se figura të tilla, që e nderojnë kombin, si Ismail Kadareja, nuk duhet të përfliten këtu as me të pavërteta, as me të vërteta, nuk është as në dinjitetin e çdo deputeti dhe për më tepër të Kryeministrit. Për sa i përket të drejtës suaj për të zgjedhur Presidentin e Republikës si maxhorancë, po ju them se ky është leximi juaj i gabuar i Kushtetutës. Nëse do të lexoni në frymë dhe në gërmë se çfarë është Presidenti i Republikës, do të kuptoni se ka nevojë (këtë e ka përcaktuar Kushtetuta), për konsensus.

Procedura ka përcaktuar tre të pestat për konsensus, pra, qartësisht ne duhet të ulemi dhe të gjejmë konsensus. Këtu vijmë në një moment tjetër. Ju nuk mund të zgjidhni kundërshtarët tuaj. Kundërshtarët tuaj janë ata që janë, por ne vetë si opozitë duhet patjetër të kemi një qëndrim të përbashkët. Ky qëndrim i përbashkët për hyrjen në negociata, për emrin e Presidentit, për zbatimin e procedurës ose jo, duhet të vijë nga kjo opozitë në mënyrë të përbashkët.